



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202503001/2

Tiranë ____/____/2025

Lënda: Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier.

Drejtuar: Bashkisë Fier

FIER

Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Shtëpisë së të Moshuarve

FIER

Të nderuar,

Avokati i Popullit, Ju falenderon për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucioneve që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona. Në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (**MKPT**), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve Fier, më datë 04.07.2025 sipas Planit të Inspektimit për vitin 2025 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Lindita Dedëgjoni, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë ndihmës komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre, mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe

trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj të moshuarve të akomoduar në qendër të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës fizike tej kufijve në tejkalim të standardeve, apo dhe mbajtjen në qendra rezidenciale pa vullnetin e tyre.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin ligjor, t'ju parashtojë përfundimet e këtij monitorimi.

Objektivat e inspektimit:

- Niveli i vlerësimit të dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi,
- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2024 si dhe gjendja aktuale,
- Niveli i respektimit të të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit,
- Vlerësimi i kushteve infrastrukturore për një trajtim të denjë të këtyre të moshuarve.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i përbërë nga një juriste, një psikologe dhe një mjeke si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtoren e qendrës dhe përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit, sipas Udhëzimit nr. 168, datë 29.03.2024 "Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit".
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve në Fier), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi individual dhe kofidencial me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier.
- ***Së pesti***, vlerësimi i dokumentacionit mbi të cilin Shtëpia e të Moshuarve në Fier zhvillon aktivitetin.

Rekomandimet e vitit 2024 dhe niveli i zbatimit të tyre

Nga inspektimi i mëparshëm i kryer më datë 10.05.2024 në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier, për problemet e konstatuara, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

1. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkia Fier për shtim fondi buxhetor, në parashikimet e buxhetit për vitin 2025 për Shtëpinë e të Moshuarve Fier, me qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse sipas nevojave.
2. Marrjen e masave nga Bashkia Fier me miratimin e organikës për vitin 2025, të Shtëpisë së të Moshuarve Fier, për shtim në organikë të pozicionit të punës për 2 infermierë dhe kujdestarë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe për shtim të numrit të stafit të specializuar fizioterapitë dhe psikolog.
3. Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.
4. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror gjatë vitit 2024, për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier.
5. Marrjen e masave menjëherë nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve Fier, që kampionet ushqimorë të ruhen të etiketuar sipas standardeve të përcaktuara.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka informuar¹ në përgjigje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ndërkohë gjatë inspektimit nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve në Fier u informuam:

- *Për rekomandimin nr.1*, për shtim fondi buxhetor, në parashikimet e buxhetit për vitin 2025 për Shtëpinë e të Moshuarve Fier, me qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse sipas nevojave, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se Shtëpia e të Moshuarve, Fier është në administrim të Bashkisë Fier dhe ShSSH alokon fonde vetëm për paga, sigurime dhe shpenzime operative. Investimet mund të mbulohen ose nga Bashkia Fier ose donatorët.
- *Për rekomandimin nr.2*, rekomandim i përsëritur, për shtim në organikë të pozicionit të punës për 2 infermierë dhe kujdestarë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe për shtim të numrit të stafit të specializuar fizioterapitë dhe psikolog, ShSSH nuk ka kthyer përgjigje. Nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve në Fier u informuam se nuk ka shtesa në organikë.
- *Për rekomandimin nr.3*, për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka

¹ Shkresë nr. 6190/1 datë 15.08.2024 “Kthim përgjigje”

kthyer përgjigje, megjithëse ky rekomandim vjen i përsëritur, nuk është kryer asnjë procedurë.

- *Për rekomandimin nr.4*, për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier, Shërbimit Social Shtetëror informon se ka realizuar në bashkëpunim me European Commission, Sue Ryder Care Albania dhe Bashkinë e Tiranës për trajnimin e Përgjegjësve Social dhe Psikologëve të institucioneve rezidenciale dhe ditore për të moshuar trajnim 3 ditorë me temë “Fuqizimi i kujdesit për të moshuarit: Një qasje gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve të mirëkoordinuara për të moshuarit”.
- *Për rekomandimin nr.5*, kampionet ushqimorë të ruhen të etiketuar sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve Fier ishin marrë masat për etiketimin e kampionëve ushqimor.

Bashkia Fier **nuk ka** kthyer përgjigje për rekomandimet e Avokatit të Popullit. Gjatë viteve 2022, 2023 dhe 2024, në mënyrë të përsëritur kemi konstatuar një neglizhencë nga administrata e Bashkisë Fier, si dhe një nivel të ulët të bashkëpunimit me Avokatin e Popullit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se kishin gjetur zbatim pjesërisht një pjesë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit² në inspektimin e mëparshëm:

- Ishin marrë masa për trajnime për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier.
- Ishin marrë masa për ruajtjen e kampioneve ushqimorë të etiketuara sipas standardeve

Ndërkohë rekomandimet e Avokatit të Popullit që nuk janë realizuar, më konkretisht:

- **Nuk** është realizuar rekomandimi për shtim fondi buxhetor, në parashikimet e buxhetit për vitin 2025 për Shtëpinë e të Moshuarve Fier, me qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse sipas nevojave.
- **Nuk** është realizuar rekomandimi për shtim të stafit të specializuar, mjek me kohë të plotë, fizioterapitë dhe psikolog.
- **Nuk** është realizuar rekomandimi për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.

Avokati i Popullit ka evidentuar dhe rekomanduar ndër vite në mënyrë të përsëritur që institucioni duhet të ketë buxhet të mjaftueshëm, për të siguruar shërbime të përshtatshme për një pjesë të të moshuarve që janë me probleme të rënda shëndetësore. Gjatë inspektimeve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 është konstatuar mungesa e fondeve për shërbime të përshtatshme në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, për të përmirësuar kushtet e jetesës të përfituesve të kësaj qendre, duke e vendosur qendrën në vështirësi

² Rekomandim Nr. K4/I3-2 prot, datë 08.08.2024, “Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier”.

financiare dhe në këtë mënyrë, është detyruar për të kërkuar investime apo fonde për zhvillime të aktiviteteve nga donatorët³.

Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 168, datë 29.03.2024 "Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit", ka si qëllim: *"të mundësojë një qasje me qendër personin duke u fokusuar te rezultatet për të moshuarit dhe kujdesin që e vendos çdo person në qendër të gjithçkaje që bën shërbimi"*, duke u bazuar te parimet kyçe për institucionet rezidenciale për të moshuarit: *"Institucioni ofron kujdes dhe mbështetje për të nxitur autonominë dhe një cilësi të shkëlqyer jetese për njerzit që jetojnë në shërbim"*.

Për përmirësimin dhe zbatimin e këtyre standardeve, nevojitet që Shërbimi Social Shtetëror të monitoroj dhe të bëjë vlerësim për ecurinë dhe nevojat e të moshuarve që jetojnë në këtë qendër rezidenciale.

Bashkia Fier pas kalimit të kompetencave të menaxhimit të Shtëpisë së të Moshuarve Fier në nivel lokal, ka detyrimin të planifikojë dhe alokojë fonde nga buxheti lokal për funksionimin dhe mirëmbajtjen e kësaj qendre rezidenciale. Gjithashtu nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit Social duhet të kryejë përgjegjësitë e saj ligjore për sigurinë dhe mirëqënien e të moshuarve.

Nga ana e Drejtores së qendrës, znj. Dorina Gjino u informuam, për përfundimin e rikonstruksionit të godinës, si dhe pajisjen me mobiliat e nevojshme nga Agjensia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim⁴.

Aktualisht nga Agjensia Turke TIKA, ishin kryer punime për restaurime dhe lyerje të ambienteve të përbashkëta dhe dhomave të të moshuarve, rregullim dhe instalim të tualeteve, izolim tarrace, si dhe rinovim të mobilie në dhomat e të moshuarve sipas projektit të kryer nga TIKA. Kryerja e këtyre punimeve në godinë ka filluar në datë 07.05.2024⁵ dhe kanë zgjatur për një periudhë 4 mujore. Përveç punimeve dhe restaurimit të ambienteve dhe të godinës, nga ana e Agjensia Turke TIKA, ishin dhuruar pajisje dhe mobilje për dhomat e të moshuarve të akomoduar në këtë qendër, si shtretër gjumi me dyshekë 49 copë, dollapë rrobash 55 copë, komodina 55 copë, si dhe materiale të buta etj.

Avokati i Popullit gjen rastin të theksoj se kushtet infrastrukturore luajnë rol të rëndësishëm dhe institucioni duhet të ketë buxhet të mjaftueshëm për të përmirësuar kushtet e jetesës të përfituesve të qendrave rezidenciale. Menaxhimi i Shtëpisë së të Moshuarve Fier në nivel lokal dhe kalimi i kompetencave Bashkisë Fier nuk është në përputhje me përgjegjësitë që kjo e fundit ka për këto qendra, të cilat duhet të trajtohen

³ "Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në 4-15 Maj 2023, në raportin datë 24 nëntor 2023, me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare, ka shprehur edhe një herë rezerva në lidhje me mbështetjesn e pamjaftueshme financiare nga autoritetet qeveritare për shtëpitë e kujdesit shoqëror".

⁴ Procesverbal dorëzim projekti në kuadër të projektit të rikonstruksionit dhe mobilimit të Shtëpisë së të Moshuarve Fier- punime rikonstruksioni, datë 16.09.2024

⁵ Shkresë nr. 34 prot. datë 07.05.2024, "Njoftim për fillimin e punimeve nga Agjensia Turke TIKA".

me kujdes nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila duhet të realizoj mbështetjen financiare për të garantuar të drejtat e njeriut dhe standardet e shërbimit ashtu siç është e parashkruar si në Kushtetutë dhe në ligj.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit.

Shtëpia e të Moshuarve në Fier, është një institucion rezidencial dhe ofron shërbime të përkujdesjes për të moshuar në nevojë, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky institucion është nën administrimin e Bashkisë Fier e cila duhet të jetë përgjegjëse dhe për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së shtëpisë. Mbështetja financiare duhet të jetë e garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Institucioni është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe raporton për problematika të ndryshme pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Fier.

Shtëpia e të Moshuarve në Fier, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar apo të braktisur, dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni, së bashku me përshkrimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të tij⁶, e cila është e afishuar në ambientet e institucionit.

Monitorimi i zbatimit të standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, kryhet nga Bashkia Fier, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Instituti i Higjienës dhe Agjencia Kombëtare e Ushqimit.

Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara.

Nga konstatimi paraprak u evidentua se në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për gra dhe 65 vjeç për burra.

Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për 55 persona të moshuar.

Gjatë inspektimit u evidentua se në këtë institucion trajtohen 52 të moshuar, nga të cilët 16 gra dhe 36 burra. Nga dokumentacioni rezulton se në qendër përfitojnë trajtim 11 të moshuar nga mosha 60-70 vjeç, 29 të moshuar nga mosha 70-80 vjeç dhe 12 të moshuar mbi moshën 80 vjeç.

⁶ Miratuar me shkresë të Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier, datë 15.01.2024.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 42 të moshuar dhe 10 të moshuar trajtohen⁷ nga qendra në mungesë të pensionit të pleqërisë.

Nga informacioni i marrë për 6-mujorin e parë të vitit 2025 rezulton se:

- Asnje i moshuar nuk është kthyer në familjen e tij, por një i moshuar është transferuar në Qendrën Polican me dëshirën e tij;
- Kanë ndërruar jetë nga shkaqe natyrore 8 të moshuar, grupmosha 70-85 vjeç;
- Kanë ardhur 11 të moshuar të rinj, nga të cilët 7 të moshuar nga ShSSH dhe 4 të moshuar nga Bashkia Fier.

Rreth 90% e të moshuarve janë me probleme shëndetësore dhe kanë një ose më shumë sëmundje kronike dhe një e moshuar është me probleme të rënda shëndetësore, e cila nuk është në gjendje të kryejnë vetë shërbimet e saj. Aktualisht **33 persona të moshuar vuajnë nga probleme të shëndetit mendor**. Nisur nga këto fakte, kujdesi shëndetësor për të moshuarit duhet të jetë tërësor dhe i integruar, të përfshijë profesionistë të ndryshëm shëndetësorë që trajtojnë aspekte të ndryshme të kujdesit shëndetësor.

Numri i lartë i personave të moshuar që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, si dhe shfaqja e këtyre sëmundjeve në mënyrë atipike kërkon nxitjen dhe ruajtjen e shëndetit të të moshuarve mbi bazën e një plani individual, nëpërmjet kryerjes së vizitave dhe analizave të nevojshme, me qëllim diagnostikimin e hershëm të tyre dhe trajtimin e përshtatshëm me medikamente.

Në udhëzimin nr.168, datë 29.03.2024, “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”, standardi 9 “Shëndeti dhe mirëqenia e përdoruesve të shërbimit”, përcakton se shërbimi mbështet optimizimin e shëndetit dhe mirëqenies së përdoruesve të shërbimit. Promovimi i shëndetit, parandalimi i sëmundjeve dhe menaxhimi i sëmundjeve kronike të të moshuarve, është një ndër fushat kryesore të parashikuara në standarde që duhet të garantohet nga qendrat rezidenciale. Kjo, për faktin se, kujdesi shëndetësor për të moshuarit është një proces shumë i rëndësishëm dhe që ndikon drejtë për së drejti në jetët e tyre.

Mjekja me kohë të pjesshme që është e angazhuar në qendër është përgjegjëse për ndjekjen e ecurisë shëndetësore për të gjithë të moshuarit. Bashkë me mjekun e familjes administrojnë kartelat individuale për gjithësecilin të moshuar. Vizitat dhe egzaminimet periodike kryeheshin në Spitalin Rajonal Fier, përkatësisht 2 herë në vit për diabetikët dhe 1 herë në vit për të moshuarit me sëmundje kardio-pulmonare. Mjekja e qendrës në bashkëpunim me mjeken e familjes në Qendrën Shendetesore nr.2, në Fier, japin rekomandim për të mjeku specialist dhe të moshuarit dërgohen në datat respektive të

⁷ Trajtohen sipas VKM nr.518, datë 04.09.2018, pika 68, a), për “Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

shoqëruar nga kujdestaret ku marrin dhe mjekimin ose jo në varësi të rezultatit të kontrolleve.

Për vitin 2025 janë kryer 14 “Check up” sipas grup moshës.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 konkretisht ishin kryer mesatarisht mbi 100 vizita periodike në muaj dhe ishin dhënë 69 rekomandime për vizita te mjeku specialist.

Shërbimi dentar ofrohej falas nga klinika dentare “Dental Turk” për të gjithë të moshuarit, për të cilët sipas nevojave ishin kryer ndërhyrje të ndryshme. Për 6-mujorin e parë të vitit 2025 ishin kryer rreth 22 shërbime dentare nga klinika dentare “Dental Turk”.

Gjendja e sigurimit të medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit vazhdonte të ishte e njëjtë, të gjitha medikamentet e nevojshme ishin të rimbursueshme dhe nuk kishte probleme me marrjen e tyre, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, mbulohejshin me fondet e vetë institucionit. Në ambientet e infermierisë u kontrolluan dhe sasia e ilaçeve që ishte në dispozicion, të cilat ishin brenda afatit të skadencës.

Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 24 punonjës⁸ nga të cilët janë me kohë të plotë 20 punonjës dhe me kohë të pjesshme 4 punonjës përkatësisht: 1(një) mjek, 1(sanitare dhe 1 (një) kujdestare.

Gjatë turnit të parë punojnë 1(një) kujdestare (infermiere) dhe 6(gjashtë) sanitare dhe 1(një) roje. Gjatë turnit të dytë punojnë 1(një) kujdestare 1(një) sanitare dhe 1(një) roje. Gjatë turnit të tretë punon vetëm 1 (një) kujdestare.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale. Shërbimet shoqërore ofrohen nga 5 kujdestarë me kohë të plotë dhe 1 (një) kujdestare me kohë të pjesshme.

Megjithëse vlerësimi i punës së stafit bëhet 2 herë në vit nga drejtuesja e institucionit, në dosjet e personelit të stafit të qendrës nuk ishin vlerësimet e punës. Një kopje e vlerësimit të punës dërgohet në Bashkinë Fier.

Nga bisedat konfidenciale me të moshuarit tregohej për përkushtimin e stafit për të ndihmuar dhe ofruar shërbime, personeli në këtë qendër nuk ishte i mjaftueshëm në asnjë prej turneve, por veçanërisht në turnin e dytë e të tretë personeli është krejt i pamjaftueshëm. Prania e kufizuar e stafit ishte e papajtueshme me nivelin e paaftësisë fizike të këtyre prej banorëve, sasinë e detyrave që duheshin kryer (ndërrimi i pelenave, ndihma në ushqyerje, ndihma në veshje dhe zhveshje, ndërrimi i çarçafëve, organizimi i aktiviteteve, etj.).

Mungesa në organikë e infermierëve, në mungesë edhe të mjekut në gjysmën e ditës, e bën të vështirë ofrimin e një shërbimi shëndetësor bazik, për grupmoshën e kësaj

⁸ Urdhër nr 468 prot, datë 17.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë Fier “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Fier për vitin 2024”

qendre, pasi kujdestaret që janë infermiere në profesion, duhet të bëjnë punë të dyfishtë, duke sjellë mungesa në kontrollet e rregullta të banorëve, regjistrime jo të duhura të parametrave jetësore dhe të mjekimeve që u jepen banorëve.

Nga inspektimet e kryera ndër vite është konstatuar se ka nevojë për të shtuar burimet njerëzore në shërbim të të moshuarve, veçanërisht me persona që ofrojnë përkujdesje për ta, duke qenë se vazhdon të jetë një ngarkesë e madhe puna e kujdestarëve, kjo mbetet një kërkesë edhe në vijim.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale, ndërkohë që qendra nuk ka psikologe.

Shërbimet shoqërore ofrohen nga 5 (pesë) kujdestarë sociale dhe 8 (tetë) sanitare.

Institucioni ka dy roje objekti të mbështetur nga fondet e Bashkisë Fier. Të dy rojet e objektit mbulonin vetëm dy turnet e para dhe në ditët e pushimit institucioni ngelej pa roje, Kjo situatë paraqet një rrezik të shtuar për largimin e të moshuarve me probleme shëndetësore, veçanërisht për ata që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, duke i ekspozuar ata ndaj rrezikut për të humbur apo lëndime jashtë ambienteve të qendrës.

Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve në Fier

Shtëpia e të Moshuarve në Fier ndodhet në një godinë dy katëshe. Ndarja e ambienteve dhe dhomave edhe pas rikonstruksionit të godinës ishte e njëjtë. Në katin e parë të kësaj godine gjenden dhomat për të moshuarit meshkuj me probleme shëndetësore, zyrat e administratës dhe mensa. Në katin e dytë gjenden dhoma fjetjeje ku ishin të sistemuar të moshuar burra në një seksion dhe të moshuara gra në seksionin tjetër si dhe sala e aktiviteteve, përkatësisht:

- Kati i parë 8 dhoma për të moshuar burra;
- Kati i dytë 15 dhoma për të moshuar burra dhe 6 dhoma për të moshuara gra.

Pas rikonstruksionit të godinës, grupi inspektues konstatoi se ambientet e këtij institucioni, ishin në kushte optimale, pa lagështire dhe me ndriçim. Dhomat ishin të mobiluara me krevat, dollapë dhe sendet që lidhen me kujdesin personal.

Godina në të cilën strehohen të moshuarit në Fier, megjithëse u rikonstruktua, nuk u projektua shtesë e ambienteve, dhomave dhe tualeteve, në mënyrë që të moshuarit të kenë mundësi të banojnë në dhoma me hapësira dhe kushte sipas standardeve.

Komiteti i Parandalimit të Torturave (KPT), ka nënvizuar se të moshuarit në qendrat rezidenciale duhet të trajtohen me dinjitet dhe duhet të kenë kushte të përshtatshme jetese, me hapësira të pastra dhe të sigurta.

Një problematikië e evidentuar dhe nga bisedat me të moshuarat gra, ishte se në katin e dytë ku ishin të akomoduarat të moshuarat gra, egzistojnë vetëm 2 tualete të përbashkëta në korridor dhe kishte vetëm një post dushi, për 16 gra të moshuara në qendër, çka përbënte problem si për përdorimin e dushit, ashtu edhe për përdorimin e tualeteve, duke pasur vështirësi kryesisht gjatë orarit të natës. Nga ana e qendrës duhet të merrem masa për shtimin e posteve të dusheve për të akomoduarat gra në katin e dytë.

Gjatë intervistimit pa praninë e stafit, të moshuarit nuk shfaqën ankesa dhe treguan se përveç sëmundjeve kronike për të cilat marrin medikamentet, nuk kishin patur probleme të tjera shëndetësore. Nga ana sociale dukeshin më të afruar dhe me social e të mirëkuptueshëm me njeri tjetrin.

Gjithashtu mungesa e shtesave të ambienteve në projekt, nuk bëri të mundur realizimin e një mjedis terapeutik për të moshuarit e kësaj qendre duke bërë dhe më të vështirë punën për stafin e kësaj qendre dhe në këto kushte të moshuarit që janë me sëmundjen të rënda të mos përfitojnë shërbimet e nevojshme kurative të fizioterapisë.

Megjithëse ky është një rekomandim i përsëritur dhe Shërbimi Social Shtetëror⁹ ka informuar se i ka propozuar MSHMS-së ngritjen e një shërbimi të ri për të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore, i cili të jetë në funksion të plotë me të gjitha shërbimet e duhura për këtë kategori, akoma nuk janë marrë masat e nevojshme dhe të fillojnë procedurat për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.

Megjithëse stafi i Shtëpisë të Moshuarve Fier ishte njohur me standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror¹⁰ për të moshuar në qendrat rezidenciale, nga ana e tyre nuk ishin marrë masat që këto standarde dhe të drejtat e të moshuarve të ishin afishuar, në mënyrë që dhe të moshuarit të njihen me të drejtat e tyre.

Në funksion të respektimit të dinjitetit dhe të drejtave themelore të të moshuarve, si dhe për të rritur transparencën dhe ndërgjegjësimin mbi standardet e shërbimit, rekomandohet që në ambientet e dukshme dhe të aksesueshme të Shtëpisë së të Moshuarve Fier të afishohet një material informues, i cili përmban standartet e shërbimit të kujdesit për të moshuarit, si dhe të drejtat e të moshuarve gjatë qëndrimit në institucion,

Ky material duhet të jetë i qartë, i lexueshëm dhe i afishuar në format të thjeshtuar, gjithashtu në gjuhë të kuptueshme për të moshuarit dhe nëse është e mundur, i shoqëruar me ilustrime ndihmëse.

Në një ambient të veçantë ishte vendosur edhe “kutia e ankesave”, ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve. “Kutia e ankesave” hapej një herë në muaj, nga punonjësi social i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier në praninë e një të moshuari. Për vitin 2025 nuk kishte asnjë ankesë.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në koridore sipas standardeve. Kolaudimi i tyre bëhet 1 herë në vit. Stafi ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Gjatë inspektimit, nuk u paraqiten probleme për furnizimin me artikujt hotelerie. Ky furnizim përgjithësisht realizohej nga fondet e institucionit si dhe nga donacione të ndryshme.

⁹ Shkresë e Shërbimit Social Shtetëror, nr. 393 prot, datë 06.04.2023.

¹⁰ Udhëzimin nr.168, datë 29.03.2024, “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”

Ngrohja në dimër realizohet me kaldajë (6 orë në ditë) dhe me kondicionerë në dhomat e katit të dytë dhe në mense dhe me kaldajë e kalorifer për dhomat e katit të parë.

Ftohja realizohet me kondicionerë për dhomat e katit të dytë dhe në mensë dhe me ventilator për dhomat e katit të parë

Ambienti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, frigorifer etj. Gjatë verifikimit të kushteve higjeno-sanitare, konstatuam se për përgatitjen e ushqimeve përdorej pajisje gatimi prej alumini. Përdorimi afatgjatë i këtyre enëve, sidomos në temperatura të larta, konsiderohet i dëmshëm për shëndetin, veçanërisht për të moshuarit me probleme shëndetësore. Në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore këto enë gatimi duhet të hiqen nga përdorimi dhe të zëvendësohen me enë të prodhuara nga materiale më të sigurta dhe rezistente, siç janë çeliku inoks, qeramika ose materiali inox i certifikuar për përdorim në kuzhinë.

Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer dhe ishin të etiketuara me datën përkatëse, pas rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit.

Kuota ushqimore prej 430 lekë në ditë¹¹, ishte e mjaftueshme për të moshuarit, të cilët nuk poaraqiten ankesa për cilesinë apo sasinë e ushqimit. Nga stafi i qendrës, në mënyrë që t'u siguronte banorëve një dietë të shëndetshme dhe të larmishme, merrte mendimin e të moshuarve për përcaktimin e menysë dhe oraret e vakteve të ngrënies. Menyja javore firmoset nga një i moshuar, e cila mund edhe të ndryshohet po nga të moshuarit sipas preferencave. Menuja javore ishte e afishuar në kuzhinë.

Ambientet e përbashkëta në katin e parë dhe në katin e dytë ishin të pastra, me dritë natyrale dhe të freskëta. Banorët kishin akses të lirë në mjediset e qendrës dhe në mjediset e jashtme të oborrit. Në pjesën e jashtme kishte nevojë për stola dhe kënde argëtimi, për ta bërë ambientin më përfitues për banorët. Në ditën e inspektimit të moshuarit u takuan nga ana jonë në lulishte dhe në ambientet e jashtme të godinës, pa praninë e stafit.

Ambientet ishin të monitoruara me sistem kamerash i cili ishte funksional i përbërë nga 16 kamera. Filmimet e tyre ruhen 2 javë dhe menaxhohen nga drejtuesja i qendrës.

Ambienti i lavanterisë ishte në katin e parë të godinës dhe kishte në gjëndje pune 5 lavatriçe dhe 1 tharëse rrobash.

Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, u informuam që organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, si dhe festat zyrtare. Nga Drejtoria e qendrës u informuam se mungesa e fondeve të mjaftueshme për shërbime nuk bënte të mundur organizimin e aktiviteteve për të moshuarit.

Në sallën e aktiviteteve në katin e dytë të godinës, është e vendosur një bibliotekë dhe televizor, ku të moshuarit kalojnë një pjesë të kohës në shoqëri të njeri-tjetrit, me lojëra

¹¹ Udhëzimi nr. 662, datë 06.12.2022, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018, për nivelin e kuatove të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror",

dhe aktivitete. Gjatë inspektimit atmosfera në sallë ishte e qetë, aty po qëndronin disa të moshuar që bisedonin dhe shikonin televizor.

Të moshuarit vizitohen nga të afërmit e tyre. Takimet e realizuara pasqyrohen në një regjistër të veçantë. Në qendër nuk kishte asnjë të moshuar që ishte i braktisur nga familjarët.

Nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit. Ata konfirmonin gatishmërinë e stafit për të plotësuar çdo kërkesë të tyre.

Problematikat e konstatuara:

- Konstatohet se megjithë miratimin e Udhëzimit nr. 168, datë 29.03.2024 "Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit", edhe pas rikonstruksionit qendra plotëson pjesërisht standardet për trajtimin e të moshuarve.
- Konstatohet se, pas rikonstruksionit të godinës nuk ishte zgjidhur problemi i tualeteve dhe dusheve, në mënyrë që të moshuarit të kenë mundësi të banojnë me kushte sipas standardeve.
- Konstatohet se, qendra vazhdon të mos ketë fonde të mjaftueshme për të siguruar trajtim të përshtatshëm pasi mbulon vetëm nevojat bazë dhe mungesa e fondeve nuk i jep mundësi qendrës të zhvillohen aktivitete të ndryshme dhe të krijohen kushte të përshtatshme jetese, si dhe të ofrohen shërbimet e duhura.
- Konstatohet se, mungesa e një mjedisi terapeutik të përshtatshëm për të moshuarit e kësaj qendre, e bën dhe më të vështirë punën për stafin e asaj qendre. Të moshuarit që janë me sëmundjen të rënda e kanë të pamundur të përfitojnë shërbimet e nevojshme kurative të fizioterapisë.
- Konstatohet se, disa nga rekomandimet që janë të përsëritura, të lëna nga Avokati i Popullit, për shtesë me punonjës të specializuar, janë të pazbatuara, çka sjellë vështirësi në menaxhimin e punës dhe për rrjedhojë mungesë në ofrimin e shërbimeve për të moshuarit.
- Konstatohet se, numri i rojeve në qendër është i pamjaftueshëm, ditët e pushimeve qendra është pa roje, duke rrezikuar sigurinë e personave të moshuar që janë me probleme të shëndetit mendor.
- Konstatohet se, standardet e shërbimit të kujdesit për të moshuarit, si dhe të drejtat e të moshuarve gjatë qëndrimit në institucion nuk janë të afishuara.
- Konstatohet se, enët në kuzhinën e institucionit që përdoren për gatim janë të aluminit, të cilat përbëjnë rrezik për shëndetin e të moshuarve.

Për sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkia Fier për shtim fondi buxhetor, për Shtëpinë e të Moshuarve Fier, me qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse, si dhe zhvillimin e aktiviteteve për të moshuarit e kësaj qendre.
2. Marrjen e masave nga Bashkia Fier, për shtim në organikë të Shtëpisë së të Moshuarve Fier, të pozicionit të punës për 2 infermierë dhe kujdestarë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe për shtim të një punonjësi roje.
3. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror, për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.
4. Marrjen e masave nga Bashkia Fier, për pajisjen me stola dhe kënde lojërash të ambientit të jashtëm të qendrës, për krijimin e një mjedisi argëtues dhe sa më përfitues për banorët.
5. Marrjen e masave menjëherë nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve Fier për zëvendësimin e enëve të aluminit në kuzhinë me enë të prodhuara nga materiale më të sigurta dhe rezistente, siç janë çeliku inoks, qeramika ose materiali inox i certifikuar për përdorim në kuzhinë.
6. Marrjen e masave menjëherë nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve Fier, që të afishohen standardet e shërbimit të kujdesit për të moshuarit, si dhe të drejtat e të moshuarve gjatë qëndrimit në institucion,
7. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror në përputhje me Udhëzimin nr. 168, datë 29.03.2024 "Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit". për të organizuar punën për monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe përmirësimin e standardeve në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

**Mekanizmi Kombëtar për
Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër,
çnjerëzor ose poshtërues
(MKPT)**

AHMET PRENÇI